

Pastërtia (5:1–7)

Një vëzhgim mbi seksualitetin në Amerikë pati rezultate të mira dhe të këqija, në të njëjtë kohë. Lajmi i mirë ishte se përskrimi që i bën media kulturës amerikane si kaldajë seksualiteti nuk është pamja e vërtetë. Shumica e amerikanëve janë «çuditërisht konservatorë». Xhon H. Gagnon, profesor sociologjie në Universitetin Shtetëror të Nju Jorkut, raportoi se 85 për qind e grave të martuara dhe më shumë se 75 për qind e burrave të martuar thanë se kanë qenë besnikë ndaj bashkëshortëve të tyre. Ky është lajmi i mirë.

Lajmi i keq është se 1 në 4 burra dhe 1 në 6 gra kanë qenë jobesnikë ndaj bashkëshortëve të tyre. Gjysma e meshkujve amerikanë kanë pasur marrëdhënie seksuale me më shumë se gjashtë partnerë gjatë jetës së tyre. Këta partnerë mund të jenë gratë, ish-gratë dhe të dashurat. Gjysma e grave thanë se kanë pasur marrëdhënie intime me më shumë se dy partnerë. Vetëm 26 për qind e amerikanëve dolën se kishin vetëm një partner gjatë jetës së tyre.

Vini re se çfarë thotë Fjala e Perëndisë për pastërtinë seksuale:

Bëhuni pra imitues të Perëndisë, si bij shumë të dashur, dhe ecni në dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi dhe e dha veten e tij për ne, si ofertë e flijim Perëndisë, si një parfum erëmirë.

Por, ashtu si u ka hije shenjtorëve, as kurvëria, as ndonjë papastërti, as kurnacëri të mos zihet në gojë midis jush; as pandershmëri, as të folur pa mend e të përqeshur, të cilat nuk kanë hije, por më tepër të ketë falënderime. Të dini në fakt këtë: asnjë kurvar, ose i ndyrë ose kurnac, i cili është idhujtar, nuk ka

ndonjë trashëgim në mbretërinë e Krishtit dhe të Perëndisë. Askush të mos ju gënjejë me fjalë të kota, sepse, për shkak të këtyre gjërave, vjen zemërimi i Perëndisë mbi bijtë e mosbindjes. Mos jini, pra, shokë me ta (5:1–7).

Kam lexuar për një kafshë të quajtur *ermelin* e cila jeton në Evropën Veriore. Në verë ermellini ka gëzof ngjyrë kafe. Në dimër gëzofi i tij merr ngjyrë të bardhë. Kjo kafshë është shumë krenare për gëzofin e bardhë dhe bën çështje e mundur për ta mbajtur atë të pastër. Në fakt, kur gjuetarët gjejnë një strofull ermellini, ata e dinë si të veprojnë. Ata lyejnë hyrjen e strofullës me zift dhe pastaj lëshojnë qentë që të ndjekin kafshën të futet brenda në strofull. Kur ermellini shikon ziftin, nuk do që të hyjë brenda në strofull që të mos bëjë pis gëzofin. Ermelinit do t'i duhet të ndeshet me qentë dhe gjuetarët duke qenë në kurth. Ermelinet me gëzof të bardhë e vlerësojnë pastërtinë më shumë se jetën. E njëjta gjë duhet të jetë e vërtetë edhe për ne që bartim emrin e Krishtit.

Pse ka kaq rëndësi për Perëndinë pastërtia jonë seksuale? Shikoni këtë përgjigje:

Pastërtia, në thelb, është reflektim i karakterit dhe i prezencës së Perëndisë në jetën tonë. Për sa kohë jetojmë duke pasur pastërti seksuale, i pasqyrojmë tërë botës se Perëndia punon brenda nesh, duke u dhënë formë dëshirave, zgjedhjeve dhe veprimeve tona, duke mos ia lenë kontrollin e tyre hormoneve.

...Në thirrjen që na bën për të qenë seksualisht të pastër, Perëndia na kërkon që të bëhemi modeli i pastërtisë dhe i besnikërisë për vëllezërit dhe motrat tona kristianë (shikoni te Efesianëve 5:29–32). Kur

kalojmë kufijtë e vënë nga Perëndia për mirën tonë, zgjedhim një rrugë që, edhe pse mund të na sjellë kënaqësi për pak kohë, shkatërron mirëbesimin tonë të Perëndia dhe i thotë Atij se, në të vërtetë, nuk e besojmë që Perëndia e di se ç'është më e mira për ne.

Te vargjet 5:1–7, Pali u bëri thirrje kristianëve të ndjekin planin e Perëndisë për pastërtinë. Pastaj ai përshkroi pasojat që vijnë si rezultat i dështimit të ndjekjes së këtij plani.

LUTJA

Pali u lut që kristianët «të bëhen imitues të Perëndisë» (5:1). Jini si Perëndia. Më pëlqejnë numrat e imituesve. Shumica e tyre janë aktorë. Ata studiojnë mënyrën e të folurit të njerëzve të famshëm dhe përpiqen ta imitojnë atë. Ata shpesh duken sikur janë vetë njerëzit që imitojnë.

Pali tha: «Kristianë, duhet ta merrni seriozisht çështjen e imitimit të Perëndisë.» Pse, Pal?

«Sepse ju jeni fëmijët e dashur të Perëndisë», shkroi Pali. «Ju i përkisni Atij. Ju mbani emrin e Tij, kështu që nderoheni atë me anë të mënyrës si jetoni. Imitoni Perëndinë.» Fjalët e Palit janë një model që duhet të ndjekim për të nderuar dhe imituar Perëndinë.

MODELI

Në vargun 5:2 Pali dha shembullin e dashurisë së pastër: «Dhe ecni në dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi dhe e dha veten e tij për ne, si ofertë e flijim Perëndisë, si një parfum erëmirë.» Modeli që duhet të ndjekim për të imituar Perëndinë është dashuria deri në vetëflijim e vetë Birit të Perëndisë. Te Jezusi nuk gjendet asnjë ndjenjë egoizmi. Jezusi kurrë nuk ishte i dhënë pas plotësimit të nevojave vetjake. Ai kurrë nuk i përdori njerëzit për kënaqësinë e Tij vetjake. Jezusi i deshi njerëzit. Për Jezusin njerëzit kishin më shumë rëndësi se sa interesat e tij vetjake. Dëshira e Tij ishte që t'u shërbente njerëzve, jo të merrte çfarë të mundte prej tyre dhe pastaj t'i braktiste.

Papastërtia seksuale përfaqëson krejt të kundërtën e kësaj. Asgjë nuk do të ishte më egoiste se sa përdorimi i një njeriu tjetër si një objekt për të kënaqur pasionet tona. Dëshirat seksuale na bëjnë që t'i përdorim (shfrytëzojmë) njerëzit në vend që t'i duam ata.

PERVERSITETI SEKSUAL

Shturja seksuale është një prishje e dashurisë

që Perëndia krijoi për burrin dhe gruan. Në vargun 3 Pali kalon nga shembulli i përkryer i vetë-sakrifikimit të shembulli i plotësimit të nevojave vetjake. Ai përdori tri fjalë të papëlqyera. «Kurvëria» u referohet të gjitha mëkateve seksuale, duke përfshirë shkeljen e kurorës bashkëshortore, homoseksualitetin, marrëdhëniet seksuale dygjinore dhe të gjitha marrëdhëniet e tjera seksuale jashtë martesë. «Papastërtia» i referohet ndyrësisë. Kjo fjalë jep idenë e fëlliqësisë morale. E njëjta fjalë përdoret edhe te Mateu 23:27 për të përshkruar kalbëzimin e trupit në varr. «Kurnacëria» do të thotë kokëfortësi, kënaqje e vetes dhe abuzim i të tjerëve.

Pali nuk i kufizoi mendimet e tij për seksualitetin vetëm te veprimet tona. Ai gjithashtu përfshiu edhe të folurën tonë: «As pandershmëri, as të folur pa mend e të përqeshur, të cilat nuk kanë hije, por më tepër të ketë falënderime» (5:4). Perëndia nuk do që ta ulim vlerën e seksit. Seksi është dhurata e Perëndisë ndaj të martuarve. «Martesa të nderohet nga të gjithë dhe shtrati martesor i papërlyer, sepse Perëndia do të gjykojë kurvarët dhe kurorëshkelësit» (Hebrenjve 13:4). Kurrë nuk duhet të bëjmë shaka për atë që na ka dhënë Perëndia. Shumica e humorit dhe komedive në televizor bazohen mbi seksin. Njerëzit kanë shndërruar në objekt humorit diçka që Perëndia e merr shumë seriozisht.

DËNIMI

Më poshtë lexojmë: «Të dini në fakt këtë: asnjë kurvar, ose i ndyrë ose kurnac,...nuk ka ndonjë trashëgim në mbretërinë e Krishtit dhe të Perëndisë. Askush të mos ju gënjejë me fjalë të kota, sepse, për shkak të këtyre gjërave, vjen zemërimi i Perëndisë mbi bijtë e mosbindjes» (5:5–6). Cili është qëndrimi i Perëndisë ndaj kësaj lloji papastërtie? Mëkati seksual bie në kundërshtim me Perëndinë dhe mbi të Perëndia do të zbrazë të gjithë zemërimin e Tij.

PLANI

Në një film, pilotët që kryenin manovra, gjithmonë testonin kufijtë për të parë se sa shpejt dhe sa lart mund të fluturonin. Pilotët që kishin kurajon të kalonin kufirin, që të tjerët mendonin se nuk duhej kaluar, konsideroheshin «guximtarë».

Të shikojmë se sa pranë mund t'i afrohem mëkatit pa u shkatërruar nuk do të thotë se jemi «guximtarë». Të shikosh se sa larg mund të shkosh dhe akoma të jesh e virgjër, nuk është aspak ajo që

dëshiron Perëndia. Për një të martuar, «dashuriçkat e pafajshme» nuk ekzistojnë. Për një kristian, çështja nuk është se sa shumë papastërti mund të shikosh e të lexosh pa u ndikuar fare prej saj. Ajo që ka rëndësi është ajo që e kënaq Perëndinë.

Duhet të marrim me seriozitet këtë parim: *Mos u englandisni me papastërtinë.*

Një parim i dytë është ky: *Nderoni martesën.* Në qoftë se nuk jeni të martuar, qëndroni të pastër për atë ditë. Në qoftë se jeni të martuar, qëndrojeni besnikë bashkëshortit dhe mos qëndroni besnikë sa për sy e faqe. Duajeni bashkëshortin. Gëzojeni atë. Jetoni në një mënyrë që shpreh se sa i çmuar është ai për ju. Sa më shumë të përpiqeni në drejtim të kësaj, aq më e qëndrueshme do të jetë martesja juaj. Sa më e fortë të jetë martesja juaj, aq më pak të ngjarë ka që të thyeni premtimin e dhënë.

KONKLUZION

Më shqetësojnë dy çështje. Së pari, si mund t'i lexojë dikush fjalët e Palit dhe të mendojë se ato nuk na përkasin edhe neve? A i harrojmë vallë ata kristianë që njohim të cilët janë goditur prej këtij mëkati? Ka qenë një kohë kur ata do të kenë menduar: «Kurrë nuk do ta bëja një gjë të tillë. Kurrë nuk do të rrezikojta martesën. Kurrë nuk do të kisha një marrëdhënie të tillë me dikë jashtë martese.» Në Bibël lexojmë: «Përpara shkatërrimit vjen kryelartësia dhe përpara rrëzimit fryma krenare» (Fjalët e Urta 16:18). Nuk duhet të pushojmë së pasuri kujdes, për pastërtinë tonë në këtë botë ku jetojmë.

Një gjë tjetër që më shqetëson është edhe kjo: Disa njerëz janë rrëzuar dhe mendojnë se është

tepër vonë që të kërkojnë ndihmën e Perëndisë. Nuk është e vërtetë. Kisha e Perëndisë nuk përbëhet nga njerëz të përsosur, por nga njerëz të falur:

A nuk e dini ju se të padrejtët nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë? Mos u gënjeni: as kurvarët, as idhujtarët, as shkelësit e kurorës, as të zhburrëruarit, as homoseksualët, as vjedhësit, as lakmuesit, as pijanecët, as përqeshësit, as grabitësit nuk do të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë. Dhe të tillë ishit disa nga ju; por u latë, *por u shenjtëruat, por u shfajësuat në emër të Zotit Jezus dhe me anë të Frymës së Perëndisë tonë* (1 Korintasve 6:9–11).

Kisha e Zotit Jezus është vendi më i mirë ku njerëzit me moral të papastër mund të gjejnë ndihmë. Në qoftë se keni bërë mëkate seksuale, jeni të mirëpritur të vini në kishë dhe t'i shtoheni grupit të ish-gënjeshhtarëve, ish-mashtguesve dhe ish-mëkatarëve të tjerë që kanë gjetur falje te Jezusi. Jeni të mirëpritur të bashkoheni me ata që kanë nevojë për fuqinë e Tij për të lënë mënjanë mëkatet.

Të kaluarën nuk mund ta ndryshoni, por mund të faleni për mëkatet e saj. Nuk mund të bëheni përsëri të virgjër, por mund të faleni duke e nderuar Perëndinë e duke mbetur të pastër deri në ditën e dasmës. Nuk mund ta fshini faktin se nuk i keni qëndruar besnikë bashkëshortit, por mund të faleni dha ta nderoni Perëndinë duke jetuar një jetë me dashuri flijuese që këtej e tutje. Nuk mund t'i ktheni mbrapsht fjalët e ndyra që keni folur në të kaluarën, por mund të faleni dhe të nderoni Perëndinë me anë të atyre që do thoni që këtej e tutje.

Perëndia do t'ju falë. Ai do t'ju japë fuqi. Perëndia dëshiron që të jeni të pastër.

Autor: *Rusty Peterman*
Marrë nga seria: “*Efesianëve*”
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara